



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrimit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr.170/2023

Datë:26.09.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L - 117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të neneve 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, bazuar në nenin 8 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1) të Rregullores (QRK) - NR.14/2023 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në e raportin e Jurisë vlerësues me numër të protokollit 4863/2023 të datës 26.09.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Znj. Doruntina Kastrati do ta përfaqësoj Republikën e Kosovës në Pavijonin e Kosovës në Ekspozitën e 60 - të Ndërkombëtare të Artit në Bienalen e Venedikut 2024, me projekt propozimin “Heshtjet Kumbuese të Metalit dhe Lëkurës” të kuruar nga znj. Erëmirë Krasniqi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrimit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Përfaqësuesve të Pavijonit;
- Departamentit të Kulturës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. No.	4863/2023
Data / Datum	26.09.2023
Emri / Ime	Adem...
Emri i plotë / Ime i plotë	
PRISHTINE / PRISTINA / PRISHTINA	

Raporti i jurisë për Ekspozitën e 60-të Ndërkombëtare të Artit në Bienalen e Venedikut në 2024

22 shtator, 2023

Bazuar në vendimin Nr. 157/2023, të datës 18 shtator 2023, lidhur me emërimin zyrtar të jurisë profesionale nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë, z. Hajrulla Çeku.

Komisioni i jurisë, i përbërë nga kuratorë eminent, përfshirë Zdenka Badovinac, Massimiliano Gioni, Leonie Radine, Adam Szymczyk dhe artisti Alban Muja, ka shqyrtuar tetë aplikacionet e dorëzuara në thirrjen e hapur për përfaqësimin e Republikës e Kosovës në Bienalen e Venedikut në vitin 2024.


Juria unanimisht ka përzgjedhur Doruntina Kastratin për të përfaqësuar Republikën e Kosovës në Pavijonin e Kosovës në Ekspozitën e 60-të Ndërkombëtare të Artit me projekt propozimin e titulluar "Heshtjet Kumbuese të Metalit dhe Lëkurës", të kuruar nga Erëmirë Krasniqi.

Anëtarët e jurisë u bindën nga projekt-propozimi i fuqishëm, koherent dhe i shtjelluar i Doruntina Kastratit, i cili më tutje zgjeron hulumtimin e saj artistik i cili ndërlidhet me kushtet e pasigurisë në punë dhe subjektivitetin e punëtorëve në kontekstin sociopolitik dhe ekonomik të Kosovës, rajonit më të gjerë dhe Evropës. Në projektin e saj "Heshtjet Kumbuese të Metalit dhe Lëkurës" për pavijonin e ardhshëm të Kosovës, të zhvilluar ngushtë me kuratoren Erëmirë Krasniqi, Kastrati propozoi një instalacion skulpturor. Siç ceket në aplikimin e saj: "Pavijoni do të trajtoj punën e feminizuar, pabarazitë në vendin e punës dhe tëhuajsimi që vjen si pasojë. Projekti nisët nga konteksti lokal dhe shikon nga afër tranzicionet ekonomike dhe politike dhe se si ato kanë prekur grupet më të cenueshme." Si juri, na tërhoqi vëmendjen simbolika komplekse e formave skulpturore, të cilat janë të lira nga didaktika, megjithëse e kanë origjinën në angazhimin e artistes për të ekspozuar pasigurinë në punë.

Aspektet e ndryshme artistike dhe teknike të projektit, të cilat Kastrati me përpikshmëri i detajoi në propozim, përvijojnë një projekt gjithëpërfshirës i cili është i bazuar në kontekstin lokal dhe njëkohësisht lidhet me narrativat komplekse globale për kushtet në vendin e punës. Kohërencia e propozimit fuqizohet edhe më tej nga ekspertiza e gjerë e kuratores Erëmirë Krasniqi dhe fokusi i saj në historitë gojore dhe përvoja hulumtuese në Kosovë. Puna e Krasniqit përputhet me praktikën artistike të Kastratit pasi të dyja nxjerrin mësim nga përvojat personale të individëve dhe nga rrëfimet në vetën e parë. Për më tepër, projekti paraqet një plan të plotë dhe bindës të prodhimit dhe një ekip me përvojë për të zbatuar dhe për ta realizuar projektin.

Hulumtimi i gjerë, i dukshëm në konceptin kuratorial, së bashku me imazhet vizuale dhe vizatimet që përkthehen në prodhim dhe kornizë të qartë artistike, gjithashtu meritojnë vlerësim. Poashtu, objektivat e projektit dhe konsideratat e audiencës së synuar janë mirë të artikuluar. Ne jemi të bindur se projekti i Doruntina Kastratit i kuruar nga Erëmirë Krasniqi ka potencial të madh për t'u bërë një hap i rëndësishëm në trajektoren e Pavijonit të Kosovës. Anëtarët e jurisë janë krenarë dhe të lumtur që rekomandojnë një artiste dhe një kuratore të brezit të ri për të zhvilluar dhe për të realizuar me tej kontributin e jashtëzakonshëm artistik për Pavijonin e Kosovës në Ekspozitën e 60-të Ndërkombëtare të Artit në Bienalen e Venedikut 2024. Ne i përgëzojmë dhe ju urojmë suksese të mëdha në Bienale.

Zdenka Badovinac



Massimiliano Gioni



Alban Muja



Leonie Radine



Adam Szymczyk



Doruntina Kastrati (l. 1991, Prizren, Kosovë) jeton në Prishtinë dhe është artiste që punon kryesisht me skulpturë, instalacion dhe imazhe lëvizëse. Përmes praktikës së saj, Doruntina hulumton dhe fokusohet në trupin dhe marrëdhënien e tij me pushtetin biopolitik. Ajo e drejton vëmendjen ndaj çështjeve sociale dhe politike të punës në kontekstin global. Në vitin 2014 është shpërblyer me çmimin Artistët e Rinjë Vizuel nga Galeria Kombëtare e Kosovës dhe ka fituar çmimin Hajdex6 nga Fondacioni Hajde! në vitin 2017. Ajo ishte artiste në rezidencë në International Studio and Curatorial Program (ISCP) në Nju Jork në vitin 2015; në Art House në Shkodër në vitin 2018, dhe në Initiators në Athinë në vitin 2018. Puna e saj së fundmi është shfaqur në Eugster Belgrade, (2023); *Ring The Bells My Land* në Manifesta 14, Prishtinë (2022); *Temel* në Muzeun Hessel, Nju Jork, (2022); *Life without buildings* në ETH Cyrih, (2022); *Here (Air Carries Poison But Yet We Breathe)* në ChertLüdde, Berlin (2021), *What if a Journey* në Autostrada Biennale, Prizren (2021); *Bigger than Myself – Heroic Voices from ex Yugoslavia*, Muzeu MAXXI, Romë (2021); *Not Fully Human, Not Human at All* në Fondacionin Kadist, Paris, and Kunstverein Hamburg, Hamburg (2021-2022); *Tirana Patience*, Galerinë Kombëtare të Arteve, Tiranë (2020); *Public Heroes and Secrets*, Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë(2020), ndër të tjera.

Erëmirë Krasniqi është kritike e artit, kuratore dhe studiuese që vepron në Prishtinë, Kosovë. Erëmirë mori M.A. nga Kolegji Dartmouth dhe B.A. nga Kolegji Bard në Berlin. Shkrimet e saj janë publikuar në *Kosovo 2.0*, *frieze* dhe *Artforum*. Si kuratore e pavarur, ajo ka drejtuar dhe ka kuruar projekte për Galerinë Kombëtare të Kosovës, Galerinë Kombëtare të Arteve në Shqipëri, 39th EVA International, Irlandë dhe Manifesta 14, Kosovë. Praktika e saj kuratoriale dhe hulumtuese ndërthuret me arkivat, historinë gojore dhe fabulimet kritike për të llogaritur dhe korrigjuar mungesat në të dhënat historike. Interesat e saj kërkimore variojnë nga historitë e artit modernist socialist deri tek shprehjet bazë që sfidojnë narrativat historike mbizotëruese. Që nga viti 2017, Erëmirë është drejtore ekzekutive e Oral History Kosovo, një burim dixhital me qasje të hapur që angazhon forma të reja të prodhimit kulturor, duke mbështetur dhe avokuar për punën thelbësore të arkivave mediatike.

Komisionere

Hana Halilaj është kuratore dhe hulumtuese. Ajo ka kuruar një numrër ekspozitash duke përfshirë: *Eminencë Gri* (2023) dhe *Violeta Xhaferi: Rishikime* (2023) në Galerinë Kombëtare të Kosovës, *Dhomë për Kujtime të Pabëra* (2022) në Galerinë Qafa, *Clubbing Insistence: After a Party* (2022) në Doza Gallery dhe Toplocentrala, *Informator* (2022) në Muzeun e Artit Hessel, *Alije Vokshi: I Decided to Draw Bigger Hands* (2021) në Chert Lüdde dhe *Heronjtë Publikë dhe Sekretet* (2020) në Muzeun Kombëtar të Kosovës. Më parë ka ushtruar role kuratoriale në Kunsthalle Portikus dhe Storefront for Art and Architecture, si dhe ka qenë e përfshirë në hulumtim në programin C-MAP në Muzeun e Artit Modern (MoMA). Gjatë vitit akademik 2022-2023 ajo ka qenë Asistent Kuratore në CuratorLab në Universitetin e Arteve Konstfack, në Stokholm. Aktualisht, ajo është Kuratore në Galerinë Kombëtare të Kosovës. Halilaj ka përfunduar studimet master në Qendrën për Studime Kuratoriale në Kolegjin Bard.

Biografite e anëtarëve të jurisë

Zdenka Badovinac është kuratore, kritike e artit dhe drejtore e Muzeut të Artit Bashkëkohor të Zagrebit. Ajo shërbeu si drejtore e Moderna galerija në Lubjanë (1993-2020), e ndarë që nga viti 2011 në dy lokacione: Muzeu i Artit Modern dhe Muzeu i Artit Bashkëkohor Metelkova. Në punën e saj, Badovinac thekson proceset e vështira të rishkrimit të historisë krahas traditave të ndryshme avangarde brenda artit bashkëkohor. Ekspozita e parë e Badovinac që trajtoj këto çështje ishte *Body and the East: From the 1960s to the Present* (1998). Ajo gjithashtu inicioi koleksionin e parë të artit të Evropës Lindore, *Arteast 2000+*. Badovinac ishte Komisionere e Pavijonit Slloven në Bienalen e Venecias nga 1993 deri në 1997, në 2005 dhe në vitin 2017, dhe Komisioner e Pavijonit Austriak në Bienalen e Sao Paulos në 2002 dhe Presidente e CIMAM nga viti 2010 deri në 2013.

Massimiliano Gioni është drejtor artistik i New Museum në Nju Jork dhe drejtor artistik i Fondacionit Nicola Trussardi në Milano. Ai ishte bashkëthemelues i Wrong Gallery në Nju Jork (Maurizio Cattelan, Massimiliano Gioni, Ali Subotnick); kurator i 'The Zone' në Bienalen e Venecias (2003); bashkëkurator i Manifesta 5 (2004); bashkëkurator (Maurizio Cattelan, Massimiliano Gioni, Ali Subotnick) i bienales së 4-të të Berlinit (2006); drejtor i Gwangju Biennale 8 (2010); dhe kurator i Ekspozitës së 55-të Ndërkombëtare të Artit në Venecia (2013).

Alban Muja prodhon video instalacione, filma, vizatime, piktura, fotografi dhe vepra arti publik të ndikuara nga proceset e vazhdueshme të transformimeve sociale, politike dhe ekonomike në vendin e tij të lindjes në Kosovë e në Ballkan. Përmes praktikës së tij, ai hulumton në tema të historisë dhe socio-politikës, duke i lidhur ato me qëndrimin e tij në Kosovë në ditët e sotme. Ai ka shfaqur punë dhe ide në ekspozita të ndryshme personale dhe grupore, duke përfshirë festivale filmash dhe prezantimin në Pavijonin e Republikës së Kosovës në edicionin e 58-të të Bienales së Venecias. Në pavijon, ai prezantoi një video instalacion me tre kanale të titulluar *Albumi Familjar* që futet në kujtesën personale dhe kolektive

të Luftës së Kosovës (1998-1999) dhe zgjon kureshtjen mbi rolin që kanë imazhet dhe mediat në ndërtimin dhe formësimin e narrativave, identitetit dhe historisë në kohë konfliktesh.

Leonie Radine është kuratore në MUSEION – Muzeu i Artit Bashkëkohor në Bolzano. Ajo studioi histori të arti në Marburg dhe Berlin. Nga viti 2010 deri në vitin 2013, në Institutin KW për Artin Bashkëkohor në Berlin, ajo punoi si asistent kuratore e Susanne Pfeffer në ekspozitat e *Absalon*, *Wael Shawky*, *Cyprien Gaillard* et al. Nga viti 2015 deri në vitin 2022 ajo punoi në Muzeun Ludwig në Këln, ku kuroi ekspozitat *Transcorporealities* dhe *Home Visit*, ndër të tjera, dhe bashkëpunoi me Yilmaz Dziewior në retrospektivat e Haegue Yang dhe Wade Guyton. Në vitin 2018 kuroi ekspozitën e Flaka Halitit në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Si Asistent Kuratore, ajo ishte përgjegjëse për kontributin e Maria Eichhorn në Pavijonin Gjerman në Bienalen e 59-të të Venecias.

Adam Szymczyk është një kurator dhe kritik arti i cili vepron në Cyrih. Ai është kurator në Muzeun Stedelijk në Amsterdam. Ai është anëtar i bordit të Muzeut të Artit Modern në Varshavë dhe anëtar i komitetit këshillues të Koleksionit të Artit Kontakt në Vjenë, ku po ashtu ligjëron një seminar "Zbërthimi i peizazhit" në Akademie der bildenden Künste. Ai ishte Drejtor Artistik i documenta 14 në Athinë dhe Kassel në 2017 dhe shërbeu si Drejtor dhe Kurator në Kunsthalle Basel nga 2003 deri në 2014. Ai ishte bashkëthemelues i Fondacionit të Galerisë Foksal në Varshavë në vitin 1997. Ai është bashkëkurator i Elena Filipoviç, bienalës së 5-të të Berlinit për artin bashkëkohor. Në vitin 2011, ai ishte mori çmimin Walter Hopps për Arritje Kuratoriale në Fondacionin Menil në Hjuston.